



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2022:160261

Datë: 27.05.2024

Numri i dokumentit: 05737588

Ac.nr.2047/2022

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, kolegji në përbërje nga gjyqtari Ardian Ajvazi – kryetar i kolegjit dhe gjyqtarëve Hidajete Gashi Alaj e Fatmir Baloku – anëtar të kolegjit, në çështjen juridike kontestimore të paditësit H.....A..... G..... nga fshati Prigode, Komuna Istog, me vendbanim në adresë: Bruxelles, Rue Vaelhem-40, 1030 Belgique, i përfaqësuar nga Z..... G..... avokat në Istog, kundër të paditurit Sh..... B..... K..... nga fshati Prigode, Komuna Istog, me objekt të padisë pengim posedimi, duke vendosur sipas ankesës së paditësit, të paraqitur kundër Aktvendimit të Gjykatës Themelore në Pejë Dega në Istog C.nr.427/22, të datës 27.02.2023, në seancën e kolegjit të mbajtur me datën 24.05.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET si e pa bazuar ankesa e paditësit H.....A..... G..... nga fshati Prigode, Komuna Istog, ndërsa Aktvendimi i Gjykatës Themelore në Pejë Dega në Istog C.nr.427/22, i datës 27.02.2023, **VËRTETOHET**.

A r s y e t i m i

Gjykata e shkallës së parë me Aktvendimin e atakuar C.nr.427/22, të datës 27.02.2023, ka vendosur në këtë mënyrë: **I REFUZOHET në tërësi si e pabazuar** kërkesëpadia e paditësit H..... A..... G..... nga fshati Prigode, Komuna Istog, me vendbanim në adresë: Bruxelles, Rue Vaelhem-40, 1030 Belgique me të cilën ka kërkuar që të **VËRTETOHET** se i padituri Sh..... B..... K..... nga fshati Prigode, Komuna Istog, i ka bërë pengim posedimi paditësit H..... A.....G....., në atë mënyrë që në pranverë të vitit 2022, me mjete përkatëse teknike, me iniciativën, interesin dhe organizimin e tij, në mënyrë vetëgjyqësie, arbitrare pa prezencën dhe pëlqimin e paditësit, paraprakisht duke prerë disa trungje, vënë shtylla - kunjat metalik e të drurit në të cilët ka vendosur edhe një pe litar të hollë, për të caktuar drejtim, ka hyrë në pronën e paluajtshme të cilën e ka në posedim faktik, e mbanë dhe shfrytëzon, ashtu si është treguar kufiri në teren, deri në kufirin kadastral, ZK Lubozhdë, për ngastrat kadastrale nr.80913 dhe 80914, të evidentuara në certifikatën e pronës numri i lëndës 2706122 dhe kopjen e planit të

datës 2910712022, pastaj në planin kadastral dhe skicën e matjes ZK Lubozhdë, te cilat kanë shtrirje gjeografike me ngastrat fqinje: Ne anën veriore e verilindore me ngastrën kadastrale nr.80911 në pronësi të N..... L..... J..... pjesa 1/1, ne anën lindore e juglindore me ngastrën nr.82610 në pronësi P.SH Ujërat publike pjesa 1/1, më tutje, në anën perëndimore, jugperëndimore dhe veriperëndimore, me ngastrën me numër i njësisë 82310, ZK Lubozhdë, në pronësi P.SH Ujërat publike pjesa 1/1 dhe 27410 ZK Prigode në pronësi P.SH Ujërat publike, pjesa 1/1, ngastra këto që njëherit i ndajnë kufizojnë dy zona kadastrale, atë pra Lubozhde dhe Prigode, në mesin e të cilave ekziston kanali per ujitje i quajtur " Jazi i Begut ", duke filluar me hapje te kanalit nga ana veriperëndimore në drejtim jug -lindje, pika A,B,C,D,E dhe F, si pikë përfundimtare, me gjerësi mesatare prej 88 centimetra me gjatësi të përgjithshme prej 191,85 metra, aty ku nuk ka ekzistuar asnjëherë më parë dhe nuk ekziston as tani me dokumentacion përkatës kadastral, kështu që me këtë veprim paditësi është penguar në posedim, pra ndaj tij është kryer akti i pengim posedimit dhe i janë shkaktuar dëme të konsiderueshme material, të URDHËROHET i padituri qe brenda afatit 15 ditor nga dita e pranimit të këtij aktvendimi të vendosi gjendjen paraprake, në atë mënyrë që të mbylli kanalën e hapur në tërë gjatësinë e gjerësinë e tij, duke e vendosur atë në gjendje dhe pozitë normale, I ndalohej të paditurit që në këtë , apo mënyrë të ngjashme në të ardhmen të pengoj paditësin në posedim të lirë. Secila palë i heq shpenzimet e veta.

Kundër këtij Aktvendimi, në afatin ligjor, paditësja përmes të autorizuarit të saj ka paraqitur ankesë dhe atë për shkak të shkeljes thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, si dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që të ndryshohet aktvendimi i atakuar ashtu që kërkesëpadia e paditësit të aprovohet në tërësi si e bazuar, apo i njejtë të prishet dhe lënda të kthehet në rigjykim dhe rivendosje.

I padituri nuk ka paraqitur përgjigje në ankesë.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës dhe vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me pjesën e aktvendimit të ankimuar, në mbështetje të dispozitës së nenit 194 dhe 195, në lidhje me nenet 208 dhe 209 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

Ankesa e paditësit është e pa bazuar.

Gjykata e shkallës së parë pas admisnitsrimit të provave të propozuara nga palët ndërgjyqëse ka vendosur si në dispozitiv të Aktvendimit të atakuar. Në arsytimin e tij ndër të tjera theksohet se nga certifikata mbi të Drejtat e Pronës me numër 2706/2022 e datës 29.07.2022, për ngastrën kadastrale numër 809-4 me sipërfaqe prej 475 m2 e cila gjendet në zonën kadastrale Lubozhdë, Komuna Istog, vërtetohet se është në pronësi të paditësit H..... (A.....) G..... Për të vërtetuar gjendjen faktike gjykata në cilësi të provës materiale ka nxjerrë ekspertizën e ekspertit gjeodet Sh..... K..... të datës 09.11.2022, i cili me rastin e daljes në terren në prezencë të gjyqtarit të çështjes dhe palëve ndërgjyqëse ka bërë identifikimin e parcelave kadastrale me numër 809-3 (s=1625m2) me kulturë livadh i klasës së 4 dhe 809-4

(s=475m²) me kulturë livadh i klasës së 4, i cili ka konstatuar se janë parcela që shtrihen në vendin e njëjtë dhe në terren e përbëjnë një tërësi të vetme në sipërfaqe të plotë prej 2100m² dhe si të tilla kanë këtë shtrirje gjeografike në raport me parcelat fqinje: në anën veriore e veri-lindore përgjatë tërë shtrirjes së tyre kufizohen me parcelën fqinje me nr. njësie 809-1 në pronësi - posedim të: N.....(I.....) J..... 1/1, në anën lindore e juglindore përgjatë tërë shtrirjes së tyre kufizohen me parcelën fqinje me nr. njësie 826-0 në pronësi të P.SH Ujrat Publike 1/1, në anën perëndimore, jug-perëndimore dhe veri-perëndimore përgjatë tërë shtrirjes së tyre kufizohen me parcelën fqinje me nr. njësie 823-01 Lubozhdë në pronësi të P.SH. Ujral Publike 1/1 dhe 274-01 Prigodë në pronësi të P.SH Ujera Publike 1/1, parcela këto që njëherë ndajnë kufizojnë teknikisht dhe juridikisht dy Zona Kadastrale të ndryshme, atë Lubozhde dhe Prigodë. Pas matjeve të detajshme në terren dhe kalkulimeve të mëvonshme në zyre, konstatohet që: Pengimi i posedimit (që pretendohet nga ana e palës paditëse), me rastin e hapjes së kanalit të ujitjes nga ana e palës së paditur, shtrihet përgjatë anës veri-perëndimore të parcelës 21-1/1 .K.Prigode, e cila në evidencën kadastrale evidentohet në emër të: H..... G..... 1/1, në drejtimin perëndim-lindje duke filluar nga kanali faktik i betonuar në terren, e saktësisht pas matjeve precize gjatësia e kësaj pjese është: 24.44m në skicë të matjes së shënuar me pikat detaje A, 8 deri në C, pjesa tjetër e cila paraqet dhe pjesën me të gjatë të kanalit faktik të hapur në terren, shtrihet përgjatë tërë hapjes së tij në kuadër të parcelës me numër njësie 274-0/ Z .K. Prigodë, e cila në evidencën kadastrale evidentohet në emër të P.SH. Ujërat Publike 1/1, e saktësisht pas matjeve precize të bëra gjatësia e kësaj pjese është: 167,41 m, në skicë të matjes së shënuar me pikat detaje C, 0 deri në F. pika detaje F njëherë paraqet dhe pikën e fundit deri ku është bërë hapja e kanalit të ujitjes. Gjatësia e përgjithshme faktike e kanalit të hapur është 191.8Sm, në skicë pika detaje A si pikë e fillimit (në terren kanal i betonuar) deri tek pika detaje F(fundi i hapjes), ndërsa gjerësia mesatare e hapjes është 0.88m. Në terren fizikisht ka mbetur pa u lidhur ky kanal i hapur rishtazi, me një kanal faktik paraprak në fundin e tij për një distancë rreth 2,42m (në skicë nga pika detaje F deri në G). Bazuar në pohimin/deklarimin e palës së paditur, i njëjti kanal i hapur rishtazi e precizuar si më lart nuk është bërë nga ana e tij, por nga ana e KRU"Drini i Bardhë" SH.A. Sa i përket gjendjes faktike aktuale, ky kanal i hapur është i pa betonuar, e ku vetëm është bërë trasimi i tij në terren dhe heqja/pastrimi i masës së dheut e cila masë dheu është vendosur përgjatë tërë shtrirjes në anën perëndimore të tij (kah kufiri me parcelën 33-3 e palës së paditur) dhe në po të njëjtën anë/krahë vërehen disa shufra hekuri dhe druri në kuadër të cilave është i vendosur peri (litari) i bardhë nga shufra në shufër. Zyra Kadastrale Komunale në Istog disponon me shënimet origjinale takimetrore të vitit 1932-1933, të cilat të dhëna pas analizimit, kalkulimit llogaritjes së tyre ndryshojnë jashtë çdo tolerance/norme profesionale me të dhënat grafiken (kufijtë) e krijuar nga planet kadastrale. Pra, teknikisht dhe grafikisht për këtë pjesë/zonë kemi dy lloje tipe të kufijve kadastral, atë bazuar me shënime të vitit 1932-1933 dhe ato bazuar me plane kadastrale të cilat janë shoqëruar dhe me certifikatë pronësie secila parcelë. Ky ndryshim i kufijve është shkaktuar me rastin e kartirimit gabim në plane kadastrale të pikës poligonale nr.8S/L, e ku pastaj të gjithë kufijtë e parcelave të matura nga kjo pikë në vitin 1932-1933 janë kartiruar (vizatuar-pozicionuar) gabimisht në plane. Por, që pastaj mbi bazën e këtyre kufijve të kartiruar (vizatuar) në këtë formë janë llogaritur sipërtaqet e parcelave të cilat sipërfaqe janë edhe sot të evidentuara në certifikatë të pronësisë. Pra, shkurtimisht në këtë rast kemi këto dy fakte-probleme të natyrës teknike kadastrale: c1) Teknikisht, nëse kufijtë e parcelave vendosen mbi bazën e shënimeve origjinale takimetrore të vitit 1932-1933, atëherë do të ndryshojnë të gjitha sipërfaqet tekstuale

dhe grafike për parcelat e matura nga pika poligonale numër 85, në rastin konkret edhe sipërfaqet e parcelave 809-3, 809-4, 809-1, 826-0 etj Z.K. Lubozhdë dhe 33-3, 21-2 etj Z.K. Prigodë, e rrjedhimisht do të ndryshonte edhe kufiri dhe sipërfaqja e këtyre dy Zonave Kadastrale, Teknikisht, nëse kufijtë e parcelave vendosen mbi bazën e planeve kadastrale, atëherë kemi përputhje të *sipërfaqeve grafike*(me kufij nga planet) me *sipërfaqe tekstuale* (të shënuara në certifikatë pronësie), e ku në rastin konkret edhe për parcelat: 809-3, 809-4, 809-1, 826-0 etj Z.K. Lubozhdë dhe 33-3,21-2 etj Z.K. Prigode. Në këtë rast do kemi atë që quhet profesionalisht përputhje/harmonizim i pjesës tekstuale dhe asaj grafike, e ku ndryshimet dhe plotësimet nuk janë të nevojshme. Tani, në të gjitha rastet kur ekzistojnë shënimet origjinale takimetrike ato merren si bazë më e saktë dhe besueshme për ekspertim, pra në rastin konkret janë marruar për bazë kufijtë nga planet kadastrale mbështetur mes tjerash në piken c2. Gjykata ekspertizën gjeodezike e ka vlerësuar si profesionale dhe të argumentuar mirë dhe të njëjtën e ka pranuar në tërësi si të besueshme. Me qëllim të vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, gjykata ka bërë dëgjimin e dëshmitarëve të propozuar nga palët ndërgjyqëse. Dëshmitari B..... G..... ka deklaruar se unë e njoh Sh..... dhe e di që shtëpia e tij është 1km larg nga prona ku është hapur kanali, ndërsa shtëpia ime është 500-600m larg, atë ditë nuk është përmendur kanali, unë i kam parë disa njerëz aty dhe kam shkuar për të parë se çfarë po bëhet, aty ka qenë Sh....., nuk e di se kush ka qenë i interesuar për hapjen e kanalit por me sa e di i njëjti është hapur me kërkesë nga bashkësia e ujerave të Drinit të Bardhë, kur kam shkuar unë aty ka qenë vetëm një sakicë, nuk e kam parë kush e ka vendosur hunin e parë edhe pse kam qenë prezent, a e ka vendosur Sh..... apo dikush tjetër nuk e kam parë, e as kur është vendosur litari (peni) përbuz kanalit nuk kam qenë prezent. Në mes të tokës së H..... dhe Sh..... është kanali i Begut që shërben për ujitje nga qytetarët e unë jam rojtar i kanalit. Kanali i Begut i cili është në anën perëndimore dhe i betonuar ka qenë gjithmonë ndërsa kanali tjetër në drejtim të lindjes nuk ka qenë i hapur më parë, por është hapur në korrik nga kompania e ujitjes Drini i Bardhë ku unë nuk kam qenë prezent mirëpo kështu kam dëgjuar nga disa shokë, prezent kanë qenë drejtorja e bujqësisë, drejtori i kadastrës, drejtori i Drinit të Bardhë dhe përfaqësuesi i Drinit të Bardhë A... B... gjithashtu kanë qenë edhe B..... H....., S..... e H.... B....., çfarë kanë biseduar dhe çfarë kanë vendosur nuk jam në dijeni, sepse pasi që është vendosur kunja e parë unë jam larguar nga aty, para hapjes së kanalit kjo pjesë ka qenë në shfrytëzim të H..... Dëshmitari H..... K..... ka deklaruar se para rreth 15 vitesh kam qenë si ekspert gjyqësor për një kontest tjetër që është zhvilluar ku detyrë e imja ka qenë tregimi i kufirit, ka qenë kufijtë me drunjat dhe një kanal por nuk më kujtohet saktë, as emri i tij e as kujt i ka shërbyer, besoj që ka qenë pronë shoqërore, me sa më kujtohet atëherë nuk ka qenë pronar H..... por dikush J....., nuk kam informata që H..... e ka blerë dhe nuk kam dëgjuar që në tokën e H..... është hapur kanal. Dëshmitari Xh..... G..... ka deklaruar se unë Sh..... e njoh dhe e kam kojshi, shtëpitë e Sh..... dhe H..... janë përafërsisht 200 metra larg nga kanali ndërsa e imja është 200-250 metra larg, unë pasi i kam parë që po dojnë me hap kanal kam shkuar aty, Sh..... ka qenë aty dhe i njëjti i ka ngul kunjat dhe penin në tokën e H.....pasi që me kërkesë të tij është hapur ai kanal dhe të gjitha mjetet e punës skaica, sharra motorike, kunjat, bageri dhe sigjimin i ka sjelle Sh..... dhe i njëjti i ka pasur në dorë sakicën dhe sharrën motorike me të cilat i ka pre disa drunjat që kanë qenë pengesë në hapjen e kanalit, unë i kam thanë që nuk është mirë mi pre pa qenë pronari i tokës prezent. Në mes të tokës së H..... dhe Shabanit ekziston një kanal që quhet Jazi i Begut i cili shfrytëzohet për ujitje gjatë sezonës së verës dhe ka raste kur Sh.....i ka penguar njerëzit duke e hequr me traktor një presë

tjetër vetëm për të mos i lënë me ujë fshatrat tjera, Sh..... e ka tokën sipër jazit nga pjesa jugore ndërsa H..... këtej jazit nga ana veriore, gjatë sezoni të verës Jazi i Begut mbikëqyret nga roja B..... G..... Unë nuk e di çfarë raporte kanë A..... B..... me Sh....., kanali është hapur rishtazi verës, muaji nuk më kujtohet dhe kush e ka hap nuk e di, H.... e ka pasur në shfrytëzim pjesën ku është hapur kanali. Dëshmitari A... B..... ka deklaruar se unë jam në dijeni se ku ndodhet ky kanal, kalon nga pjesa perëndimore me Lubozhdën dhe vazhdon nga pjesa lindore Prigodë dhe Llukavc dhe shtrihet në mes të G..... dhe K....., aty ka pasur kanal që 100 vite, unë momentalisht jam menaxher përfaqësues i menaxhimit të ujerave nga Drini i Bardhë, kam bërë kërkesë zyrtarisht në Komunë në drejtorat të bujqësisë për me na ndihmu me kadastrë për me ardhë me verifikua ku është kanali jonë, Komuna dhe kadastra e kanë pranuar kërkesën tonë dhe kanë dalë në teren, i kanë qit pikat ka është kanali në fletë poseduese në kadastrë të Istogut, pas vendosjes së pikave në prezencë të kadastrës së Istogut është identifikuar kanali dhe dëshmohet me dokumente se është në pronësi të Bashkësisë së Ujerave dhe unë si përfaqësues i saj kam intervenuar me hap atë kanal pasi që është vërtetuar me dokumente se ky kanal është në pronësi të kompanisë tonë P.SH Bashkësia e Ujerave, nuk e kemi hapur krejt kanali sepse na kanë penguar Xh..... G..... dhe Xh.....G..... të cilët janë familjarë të H..... H..... nuk ishte aty edhe pse e kemi thirrur një muaj përpara, unë personalisht e kam thirrur duke e njoftuar se do të veprojmë kështu si kemi vepruar, e kam dëshminë edhe në telefon që e kam thirrur në Belgjikë dhe këta dy dëshmitarë e dinë, H..... më ka kërkuar afat me prit deri sa të vjen nga Belgjika, mirëpo edhe pse e kemi prituri në njëjtë nuk ka ardhur, atë kohë ka qenë sezoni i ujitjes dhe bujqit e rrethinës kërkojshin ujë nga kompania jonë ngase është kompetencë e jona dhe të gjithë fermerët kanë parashtruar kërkesë për hapjen e këtij kanali, Sh..... na ka penguar e H..... nuk vinte, mbi 100 hektar nuk janë ujë dhe kanë mbetur pa ujë edhe përkundër faktit që kanali ka qenë i betonuar. Ndërhyrja është bërë ka fundi i Qershorit dhe fillimi i Korrikut por data e saktë nuk më kujtohet, unë kam shkuar i pari aty me bager e pasi që ne kemi filluar punën ka ardhur Shabani pasi që ka menduar se po hapim kanal nga pjesa e tij, i njëjti ka qëndruar pak sa për tu informuar se ku po bëhet ndërhyrja e më vonë është larguar, pengesat që kanë qenë te toka i kemi larguar me bager sepse mjete të tjera nuk më kujtohet që ka pasur, kunjat janë vendosur në prezencën tonë por nuk e di se kush i ka vendosur. Ka shtuar se, autorizimin për ndërhyrje fillimisht e kam pasur nga kryeshefi ekzekutiv i kompanisë tonë pra me kërkesën time, leje kemi pasur edhe nga drejtori drejtorati i Bujqësisë z. A..... H..... dhe F..... K..... për çka ka qenë edhe premtim i tyre që në të ardhmen do të betonohet i njëjti, leja ka qenë verbale dhe i njëjti ka qenë prezent së bashku me stafin e tij në vendin ku është hapur kanali, bagerin për ndërhyrje e ka vozitur shoferi A..... mbiemri i të cilit nuk më kujtohet, unë ja kam dhënë detyrat të njëjtit dhe kam qenë edhe vet prezent gjatë hapjes së kanalit. Ne duke u bazuar në certifikatën pronësore dhe kopjen e planit e kemi ditur se jemi duke hapur kanalin në tokën e kompanisë sonë dhe nuk kemi asnjë pengesë nga askush pasi që e kemi pasur edhe mbështetjen e Komunës si dhe fermerëve përreth dhe se kërkesa për hapjen e kanalit është bërë nga fermerët me pëlqimin e bashkësisë së ujerave. Gjykata me rastin e vendosjes, e pas administrimit të te gjitha provave prezent në shkresat e lëndës, e duke u mbështetur në dispozitat e nenit 103, 113 par.1 dhe par.2 të të Ligjit për Pronësinë dhe të Drejtat tjera Sendore (LPDTS), dhe nenit 480 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, gjykata erdhi në përfundim se pretendimet e palës paditëse janë të pabazuara. Në bazë të nenit 103 të Ligjit për Pronësinë dhe të Drejtat tjera Sendore (LPDTS), parashihet se *“personi i cili e ushtron pushtetin faktik mbi një send është posedues i drejtpërdrejtë*

“ Me nenin 113 par.1 të këtij ligji është paraparë se “ nëse poseduesi privohet nga posedimi në mënyrë të kundërligjshme, poseduesi mund të kërkojë rivendosjen e posedimit prej personit ndërhyrës... “, ndërsa në paragrafin 2 të tij ceket se “nëse poseduesi pengohet në posedim në mënyrë të kundërligjshme, atëherë poseduesi, mund të kërkojë nga penguesi mënjanimin e pengesave. Nëse priten pengime në të ardhmen, poseduesi mund të kërkojë mbrojtje gjyqësore“. Sipas dispozitës së nenit 480, të Ligjit për Procedurën Kontestimore, shprehimisht parasheh se shqyrtimi i çështjes sipas padisë për shkak të pengim posedimit do të kufizohet vetëm në konstatimin dhe të provuarit e gjendjes së fundit të posedimit dhe të pengimit të bërë, përjashtohet mundësia e shqyrtimit lidhur me të drejtën e posedimit, me bazën juridike, ndërgjegjshmërinë dhe pandërgjegjshmërinë e posedimit. Sipas dispozitës së nenit 7, të Ligjit për Procedurën Kontestimore, palët kanë për detyrë të paraqesin të gjitha faktet mbi të cilat i mbështesin kërkesat e veta dhe të propozojnë provat me të cilat konstatohen faktet e tilla, ndërsa në dispozitën e nenit 319.1, të LPK -së, parashihet se secila palë ndërgjyqës ka për detyrë të provoi faktet mbi të cilat i bazon kërkimet dhe pretendimet e veta. Gjykata duke vendosur lidhur me kërkesë padinë e paditësit e duke u mbështetur në dispozitat e nenit 7.1, 319.1, 321, 322 dhe 480, të LPK-së, erdhi në përfundim se kërkesë padia e paditësit është në tërësi e pabazuar për faktin se me provat e administruara, paditësi nuk e ka argumentuar pushtetin e fundit faktik të posedimit për pjesën kontestuese kush, ku, kur dhe në ç’ mënyrë e ka kryer aktin e pengimit të pretenduar dhe me asnjë provë nuk e ka dëshmuar se i padituri ka kryer aktin e pengim posedimit që kërkohet në kuptim të dispozitës së nenit 480, të LPK-së, rrjedhimisht gjykata erdhi në përfundim se në rastin konkret nuk janë plotësuar asnjëri nga tri kushtet esenciale për institutin e pengim posedimit e që janë : kushtin parë pushtetin e fundit faktik, këtë rrethanë se paditësi nuk e ka pasur posedimin gjykata e ka vërtetuar nga dalja në teren ngase kanali ku është hapur është në pronësi të P.SH.SH. Ujrat Publike, i cili me pare ka qenë në me thera dhe shkurre te ndryshme pra nuk ka qenë në posedim të paditësit këtë fakt e konfirmon edhe dëshmitari A... B....., i cili ka deklaruar se me bager janë heq theret dhe drunjte që është dashur të hiqen, ndërsa sa i përket mënyrës dhe nga kush dhe si është kryer hapja e kanalit del se kanali është hapur nga kompania rajonale e ujitjes “Drini i Bardhë”, ky fakte është provuar përmes dëgjimit të dëshmitarit A... B..... i cili ka deklaruar se unë jam menaxher përfaqësues i menaxhimit të ujërave dhe kam bërë kërkesë zyrtarisht në Komunë në drejtorat të Bujqësisë për me na ndihmu me kadastrë për të ardhur me verifikua ku është kanali jonë, komuna dhe kadastra e kanë pranuar kërkesën tonë dhe kanë dal në teren, i kanë qit pikat ku është kanali në fletë poseduese në kadastrë të Istogut, pas vendosjes së pikave në prezencë të kadastrës së Istogut është identifikuar kanali i cili është në pronësi të Bashkësisë së Ujrave dhe unë si përfaqësues i saj kam intervenuar me hap atë kanal. Ndërrhyrja hapja e kanalit është bërë ka fundi i muajit Qershor apo fillimi i muajit Korrik, por data e saktë nuk më kujtohet, unë kam shkuar i pari aty me bager e pasi që ne kemi filluar punën ka ardhur Sh..... pasi që ka menduar se po hapim kanal nga pjesa e tij i cili ka qëndruar pak sa për tu informuar se ku po bëhet ndërhyrja e më vonë është larguar, pengesat që kanë qenë te toka i kemi larguar me bager sepse mjete të tjera nuk më kujtohet që ka pasur, bagerin për ndërhyrje e ka drejtuar A..... mbiemri i të cilit nuk më kujtohet, unë ja kam dhënë detyrat të njëjtit dhe kam qenë edhe vet prezent gjatë hapjes së kanalit, po ashtu edhe dëshmitari B.....G..... ka deklaruar se kanali është hapur me kërkesë nga bashkësia e ujerave të Drinit të bardhë, nga këto del së paditësi me asnjë provë nuk e ka dëshmuar se i padituri ka kryer aktin e pengim posedimit, për çka rezulton që kërkesëpadia e paditësit të jetë e pabazuar, sepse të akti i

pengim posedimit duhet të plotësohen në mënyrë komulative që të tre kushte ligjore. Andaj, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi. Posedimi si term ka të bëjë me pushtetin faktik mbi send dhe nuk i referohet pushtetit juridik, ndërsa pengimi në posedim ka të bëjë me shqetësimin apo pengimin në shfrytëzimin e pushtetit faktik apo zhveshjes nga pushteti faktik dhe assesi aspektit juridik sepse këtu kemi të bëjmë me natyrë tjetër të kontestit. Sa i përket shpenzimeve gjykata vendosi duke iu referuar dispozitës së nenit 463.1 dhe 463.2 të LPK – së.

Gjykata e Apelit nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson se qëndrimi dhe përfundimi juridik i gjykatës së shkallës së parë është i drejtë dhe i ligjshëm, pasi që aktvendimi i atakuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika (b), (g), (j), (k) dhe (m) e LPK-së, dhe e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë, për të cilat shkaqe Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të dispozitës së nenit 194 të LPK-së, ndërsa nuk qëndrojnë as pretendimet tjera ankimore të cekura në ankesë nga paditësja.

Nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të paditësit për shkeljet që i referohen dispozitave të procedurës kontestimore, për arsye se aktvendimi i atakuar është nxjerrë konformë dispozitës së nenit 142.2 dhe nenit 480 të LPK-ës, po ashtu nuk ka shkelje të tjera nga neni 182.2, pasi që arsyetimi i aktvendimit është në përputhje me dispozitën e nenit 160, par. 4 dhe 5 të LPK-së, meqë gjykata e shkallës së parë, ka dhënë arsye të mjaftueshme për faktet e çështjes, për provat që i ka shfrytëzuar për vërtetimin e fakteve dhe vlerësimin e tyre. Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, dispozitivi i aktvendimit të atakuar është mjaft i qartë, e në përputhje të plotë me arsyet e aktvendimit, duke bërë kështu që dispozitivi dhe arsyetimi, si dy pjesë përbërëse të aktvendimit, të jenë në harmoni logjike dhe juridike me njëra tjetrën. Gjykata e shkallës së parë ka arsyetuar të gjitha faktet me peshë vendimtare për refuzimin e kërkesëpadisë së paditësit, e në lidhshmëri me këtë ka arsyetuar mënyrën se si janë vërtetuar faktet, e gjithashtu edhe mënyrën se si i ka vlerësuar provat për secilin fakt të provuar. Në këtë kontest, në arsyetim të aktvendimit janë dhënë arsye të duhura për mënyrën e vërtetimit të fakteve, për provat e administruara dhe për vlerësimin e tyre sa i përket besueshmërisë dhe fuqisë provuese të tyre. Kështu, gjykata e shkallës së parë, në arsyetim të aktvendimit ka paraqitur arsye të mjaftueshme për mungesën e bazës juridike të kërkesëpadisë së paditëses.

Si rrjedhojë e këtyre, Gjykata e Apelit e pranon si të drejtë dhe të ligjshëm qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë, për sa i përket mungesës së bazës juridike të kërkesëpadisë së paditësit. Gjykata e shkallës së parë ka aplikuar në mënyrë të drejtën dispozitat materiale, kur ka refuzuar kërkesëpadinë e paditësit për pengim posedim.

Edhe gjendja faktike në këtë procedurë është vërtetuar në mënyrë të plotë dhe të drejtë, për çka nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të palës ankuese as për këtë bazë, për arsye se gjykata e shkallës së parë në procedurën e të provuarit përmes mjeteve provuese i ka vërtetuar të gjitha faktet me peshë vendimtare për këtë çështje juridike, duke vendosur sikurse në dispozitiv të aktvendimit të ankimuar. Andaj pretendimet e saj mbi këtë bazë, sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, nuk qëndrojnë, për arsye që gjykata e shkallës së parë në procedurën e të provuarit përmes mjeteve provuese që i ka cekur në arsyetim të aktvendimit të gjykatës së shkallës së parë,

e të cilat gjykata e shkallës së dytë nuk e pa të arsyeshme që t'i përsërisë edhe njëherë, i ka vërtetuar të gjitha faktet me peshë vendimtare për këtë çështje juridike, duke vendosur sikurse në dispozitiv të aktvendimit të ankimuar.

Përveç të cekurave më lartë, Gjykata e Apelit erdhi në përfundim se gjykata e shkallës së parë me të drejtë me rastin e vendosjes është mbështetur në nenin 480 i LPK-së, i cili shprehimisht thotë se: *“Shqyrtimi i çështjes sipas padisë për shkak të pengimit të posedimit do të kufizohet vetëm në konstatimin dhe të provuarit e fakteve të gjendjes së fundit të posedimit dhe të pengimit të bërë. Përjashtohet mundësia e shqyrtimit lidhur me të drejtën e posedimit, me bazën juridike, ndërgjegjshmërinë ose pandërgjegjshmërinë e posedimit.”* Në pajtim me atë që kjo dispozitë përcakton, gjykata e shkallës së parë, pas marrjes së lëndës në shqyrtim e ka shqyrtuar dhe vërtetuar gjendjen e fundit të posedimit, përfshirë këtu edhe faktin se i padituri nuk e ka kryer aktin e pengim posedimit në raport me paditësin. Si rrjedhojë, Gjykatës së Apelit i rezultoi se gjykata e shkallës së parë drejtë dhe ligjshëm ka vendosur në këtë çështje kontestimore, kur e ka refuzuar kërkesëpadinë e paditësit, duke zbatuar me saktësi dispozitën e nenit 111 të Ligjit për Pronësinë dhe të Drejtat tjera Sendore (LPDS), që tani është në fuqi, lidhur me nenin 480 të LPK-së, meqenëse është nuk provuar fakti se i padituri e ka kryer aktin e pengim posedimit ndaj paditësit.

Duke marrë parasysh të lartëcekurat, Gjykata e Apelit i refuzoi si të pabazuara pretendimet ankimore të palës paditëse, të theksuara në ankesën e parashtruar, ku përveç që paditësi nuk ka ofruar ndonjë bazë mbi të cilën Gjykata e Apelit do të vendoste ndryshe nga ajo që ka vendosur gjykata e shkallës së parë, e njëjta, edhe për ato shkelje që i ka pretenduar, nuk ka dhënë sqarime të mjaftueshme, duke e bërë kështu ankesën të mangët në kuptim të nenit 178, pika c), të LPK-së.

Meqë aktvendimi i atakuar është vërtetuar në tërësi, automatikisht vërtetohet edhe vendimi mbi shpenzimet procedurale, për të cilin gjykata, me të drejtë, është mbështetur në nenin 450, të LPK-së.

Gjykata e Apelit i mori parasysh edhe të gjitha pretendimet të tjera ankimore të palës paditëse, por të njëjtat nuk patën ndikim në vendosjen ndryshe nga ajo që është vendosur.

Nga të lartëcekurat, e në mbështetje të dispozitave nga nenet 194 dhe 195.1, pika d), 200, 208 dhe 209 pika b) të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), Gjykata e Apelit vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË

Ac.nr.2047/2023, me datën 24.05.2024

Kryetari i kolegjit - Gjyqtari
Ardian Ajvazi

Numri i lëndës: 2022:160261
Datë: 27.05.2024
Numri i dokumentit: 05737588